

**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI
NDËRMJET**

**MINISTRISË SË MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE
INFRASTRUKTURËS TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

DHE

**MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

PËR

**NDËRTIMIN E LIDHJES HEKURUDHORE
DURRËS - PRISHTINË**

Preambula

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës të Republikës së Kosovës dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të Republikës së Shqipërisë në vijim të quajtura "Palët", Duke marrë parasysh rëndësinë e bashkëpunimit dypalësh në zhvillimin e një infrastrukture të qëndrueshme përgjatë lidhjes hekurudhore Durrës - Prishtinë,

Duke riafirmuar se zhvillimi i lidhjes përgjatë Rrugës 7 (*Route 7 / Durrës – Prishtinë*) do të përmirësojë lidhjet e transportit hekurudhor në rajon dhe do të nxisë marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare,

Duke njohur rëndësinë e përpjekjeve të ndërsjella për të mbështetur iniciativat e Investimeve me Bashkimin Evropian, institucionet financiare ndërkombëtare dhe me sektorin privat për përshpejtimin e zhvillimit të lidhjes multimodale Durrës - Prishtinë,

Palët e këtij Memorandumi Mirëkuptimi kanë rënë dakord të punojnë së bashku për përparim të mëtejshëm dhe për të siguruar një infrastrukturë të transportit hekurudhor rajonal më efikase dhe moderne me cilësi të lartë.

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij Memorandumi është të krijojë një kuadër bashkëpunimi midis dy palëve për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve në linjën hekurudhore Durrës – Prishtinë. Gjithashtu nëpërmjet tij do të riafirmohet vullneti dhe gatishmëria e palëve për planifikimin afatgjatë të infrastrukturës dhe zhvillimin e koordinuar të lidhjes Durrës – Prishtinë, me fokus përmirësimin e ndërlidhjes në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Ndërtimi i infrastrukturës së re hekurudhore përgjatë lidhjes Durrës – Prishtinë do të kontribuojë për arritjen e një lëvizshmërie të qëndrueshme dhe efikasitet të lartë dhe cilësi të shërbimit të transportit, në një periudhë afatgjatë.

Ky Memorandum do të ndihmojë më tej për koordinimin dhe zbatimin e masave për të lehtësuar kalimet kufitare dhe për të siguruar korridore të mallrave për transport të shpejtë dhe të vazhdueshëm, duke marrë parasysh edhe përvojën me COVID-19.

Secila palë do të drejtojë përpjekjet e saj në ndërtimin e lidhjes hekurudhore deri në kufirin me palën tjetër.

Neni 2 Fushat e bashkëpunimit

Palët angazhohen të bashkërendojnë në fushat e bashkëpunimit, si më poshtë:

- Rehabilitimin / Ndërtimin e lidhjes hekurudhore përgjatë lidhjes hekurudhore Durrës - Prishtinë, si zgjatim i rrugës hekurudhore 7 (*Route 7 Nish – Doljevac – Prishtinë*), duke filluar me përgatitjen dhe sigurimin e financimit për të gjitha fazat e projektit nga Studimi i Fisibilitetit dhe Ndikimi i Thelluar ambiental e social, Projekti i Detajuar dhe zbatimi i tij;
- Angazhimin financiar-nga ana e të dy palëve me qëllim realizimin e aktiviteteve konkrete për ndërtimin e lidhjes hekurudhore Durrës- Prishtinë;
- Shkëmbimin e praktikave më të mira, si në rastin e përafërimit të legjislacionit përkatës të Aneksit 1 të TCT ;
- Vijimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të eksperiencave midis autoriteteve hekurudhore të të dyja vendeve për t'u njohur me teknikat, teknologjinë dhe procedurat e operimit të dy palëve, si dhe zhvillimeve të fundit institucionale të secilës palë;
- Zhvillimin e takimeve për të diskutuar çështjet me interes të përbashkët.

Neni 3 Ngritja e Komitetit të përbashkët për zbatimin e Memorandumit

Pas hyrjes në fuqi të këtij Memorandumi, do të krijohet Komiteti i Përbashkët, me qëllim garantimin dhe zbatimin efikas të aktiviteteve të bashkëpunimit në Kuadër të këtij Memorandumi.

Brenda 2 muajve pas hyrjes në fuqi të këtij Memorandumi, secila palë do të caktojë një Koordinator, për të qenë përgjegjës për menaxhimin e fushave të bashkëpunimit të parashikuara në këtë Memorandum.

Komiteti i përbashkët do të përbëhet nga një grup ekspertësh të fushës të të dy palëve të cilët do të diskutojnë me terma konkret në lidhje me kërkesën e përbashkët për financimin e të gjitha fazave të projektit, deri në zbatimin e plotë të tij, i cili konsiderohet me rëndësi rajonale dhe do të zhvillojë multimodalitetin dhe interoperabilitetin ndërmjet dy vendeve, përgjatë vijës hekurudhore.

Takimet e Komitetit të përbashkët do të zhvillohen 2 herë në vit, në Shqipëri dhe në Kosovë, sipas dakordësisë mes palëve.

**Neni 4
Ndryshimet**

Ky memorandum bashkëpunimi mund të ndryshohet nëpërmjet miratimit të ndësjelltë me shkrim të palëve në çdo kohë.

**Neni 5
Bashkëpunimi**

Bashkëpunimi i Palëve në kuadër të këtij Memorandumi Bashkëpunimi do të bazohet në një angazhim vullnetar dhe do të vazhdojë derisa të arrihen qëllimet e tij.

**Neni 6
Të drejtat dhe detyrimet e Palëve**



Dispozitat e këtij Memorandumi Bashkëpunimi nuk do të prekin asnjë të drejtë dhe detyrim të Palëve që rrjedhin nga marrëveshje të tjera dypalëshe dhe shumëpalëshe të detyrueshme për to.

**Neni 7
Hyrja në fuqi dhe përfundimi**

Ky Memorandum Bashkëpunimi do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të tij nga Palët.

Ky Memorandum Bashkëpunimi do të jetë i vlefshëm derisa njëra nga Palët ta përfundojë atë duke paraqitur një njoftim me shkrim tek Palët e tjera. Në një rast të tillë, ky Memorandum Bashkëpunimi do të pushojë vlefshmërinë e tij dhe mbetet në fuqi deri në datën e marrjes së njoftimit.

Nënshkruar në ELBASAN më 26.11.....2021, në dy kopje në origjinal, në gjuhën shqipe.

<p>Për Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës të Republikës së Kosovës</p> <p>Liburn Aliu</p> 	<p>Për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të Republikës së Shqipërisë</p> <p>Belinda Balluku</p> 
--	---